FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 96

Tiranë – E enjte, 4 korrik 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 407/1, datë 14.6.2019	Për mënyrën e përllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shoqëria "Illyrian Guard" sh.a.....	7041
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 400, datë 25.6.2019	Për miratimin e rregullores, për kushtet e shëndetit të kafshëve, që ndikojnë në tregtinë dhe përdorimin e embrioneve të kafshëve, të mbarështimit të llojit gjedh.....	7043
	Kërkesë pë shpalljen të vdekur të shtetasit Ramiz Toqi.....	7052
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Viktor Sharko.....	7052
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Dhimitër Malja.....	7052

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 407/1, datë 14.6.2019

PËR MËNYRËN E PËRLLOGARITJES SË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE SPECIFIKE, QË U OFROHEN SUBJEKTEVE PUBLIKE, NGA SHOQËRIA "ILLYRIAN GUARD" SHA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, si dhe të pikës 7, të vendimit nr. 177, datë 4.4.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e shoqërisë *"Illyrian Guard"* sh.a., dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie", ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

1. Mënyra e përllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, në fushën e rendit e të sigurisë publike, teknologjisë së informacionit, si dhe çdo shërbim tjetër në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj, nga shoqëria "Illyrian Guard" sh.a., caktohet sipas klasifikimit të objekteve.

2. Ruajtja dhe sigurimi i objekteve realizohet sipas klasifikimit të tyre, në objekte të kategorisë "I" dhe "II", duke i vlerësuar sipas:

a) rëndësisë së objektit;

b) ndërtimit arkitekturor të objektit;

c) vendndodhjes së objektit (vlerësimi ambientit/mjedisit);

d) largësisë së objektit nga vendndodhja e sh.a. "Illyrian Guard";

e) infrastrukturës së mjedisit;

f) aktivitetit që zhvillohet në objekt;

g) historiku i ngjarjeve kriminale në objekt dhe në zonë;

h) pasojave që vijnë nga dhunimi dhe cenimi i objektit;

i) sipërfaqes/madhësisë së territorit dhe numrit të objekteve që ndodhen brenda saj;

j) aftësisë dhe shpejtësisë së reagimit të grupit të gatshëm;

k) pranisë së publikut në objekt.

3. Shoqëria "Illyrian Guard" sh.a., ruan dhe siguron objektet e kategorisë "I", me shërbime të specializuara, me punonjës në zyrat e pritjes dhe me sisteme të vëzhgimit me kamera dhe sinjalizimit, ndërsa objektet e kategorisë "II" i ruan dhe siguron me shërbime të alternuara/integruara.

3/1. Vlerësimi dhe përcaktimi i masave të sigurisë së objekteve të kategorisë "I", përfshinë:

- analiza e sigurisë fizike të objektit;
- sistemi i sinjalizimit/alarmit, sipas zonave sensitive dhe perimetrit të objektit;
- sistemi i vëzhgimit me kamera, në të gjithë brendësinë dhe perimetrin e objektit;
- sistemi i komunikimit me radio e telefon;
- operatorë për monitorim të drejtpërdrejtë dhe të pandërprerë të kamerave;
- grupi i gatshëm (i cili aktivizohet në rast nevoje);
- thirrjet e emergjencës;
- pengesa fizike.

3/2. Vlerësimi dhe përcaktimi i masave të sigurisë së objekteve të kategorisë "II", përveç sa përcaktohet në pikën 3/1, të këtij udhëzimi, përfshinë:

- organizimi i shërbimit me roje;
- akses kontrolli;
- kontrolli elektronik i rojeve;
- sistemi i avancuar i vëzhgimit dhe menaxhimit;
- sistemi i komunikimit;
- zona të dedikuara.

4. Ruajtja dhe sigurimi i çdo objekti realizohet me elementë shërbimi.

I. Mënyra e llogaritjes së kostos financiare vjetore për ruajtjen dhe sigurimin e objektit të kategorisë së "I" (parë), bazohet në elementët e shërbimit dhe shpenzimeve të çdo elementi, si më poshtë vijon:

A. Personeli dhe shpenzimet e tij, detajohen në:

1. Përgjegjës objekti, 1 (një) punonjës, me kosto financiare vjetore në vlerën 1 128 820 (një milion e njëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e njëzet) lekë, bazuar në pagën bruto dhe sigurime shoqërore/shëndetësore me vlerën mujore 94 068 (nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

2. Monitorues objektesh, 5 (pesë) punonjës, me kosto financiare vjetore në vlerën 4 258 476

(katër milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, bazuar në pagën bruto dhe sigurime shoqërore/shëndetësore me vlerën mujore 70 975 (shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, për operator.

3. Grupi i gatshëm, përllogariten 10 (dhjetë) punonjës shërbimi, të cilët punojnë në çift, 24 orë në 24, me kosto financiare vjetore në vlerën 8 516 953 (tetë milionë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, bazuar në pagën bruto dhe sigurime shoqërore/shëndetësore në vlerën mujore 70 975 (shtatëdhjetëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

4. Shpenzime për uniformë, (veshmbathje) me kosto financiare vjetore në vlerën 467 500 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë për 15 punonjës. Kjo kosto bazohet në vlerën fillestare të blerjes të një uniforme në vitin e parë, plus normën e amortizimit në vitin e dytë dhe të tretë. Kjo kosto për tre vjet llogaritet në vlerën 93 500 (nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë.

B. Shpenzimet për mjetet dhe pajisjet e shërbimit, detajohen në:

1. Sistemi i kamerave të vëzhgimit, me kosto financiare vjetore 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, bazuar në vlerën fillestare 660 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, me afat përdorimi 4 vjet, kjo si rezultat i shkallës së lartë të amortizimit në vlerën 25%.

2. Sistemi barrierë elektronike/alarmi, me kosto financiare vjetore 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, bazuar në vleftën fillestare 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, me afat përdorimi 4 vjet, kjo si rezultat i shkallës së lartë të amortizimit në vlerën 25%.

3. Sistemi i akses kontrollit elektronik, me kosto financiare vjetore 231 250 (dyqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, bazuar në vleftën fillestare 925 000 (nëntëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, me afat përdorimi 4 vjet, kjo si rezultat i shkallës së lartë të amortizimit në vlerën 25%.

4. Motoçikleta për grupin e gatshëm, 2 (dy) copë, me kosto financiare vjetore 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, bazuar në vleftën fillestare të një motoçiklete në shumën 312 500 (treqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, me afat përdorimi 5 vjet, kjo si rezultat i shkallës së lartë të amortizimit në vlerën 20%.

5. Radio dore për grupin e gatshëm, 4 (katër) copë, me kosto financiare vjetore 31 250 (tridhjetë e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, bazuar në vleftën fillestare 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, me afat përdorimi 4 vjet, kjo si rezultat i shkallës së lartë të amortizimit në vlerën 25%.

6. Pajisje policie në vend shërbimi, 1 komplet me kosto financiare vjetore 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë, bazuar në vleftën fillestare 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, me afat përdorimi 5 vjet, kjo si rezultat i shkallës së lartë të amortizimit në vlerën 25%.

7. Shpenzime komunikimi dhe interneti, me kosto financiare vjetore 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

8. Shpenzime karburant/automjete, me kosto financiare vjetore 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë lekë).

C. Shpenzime administrative jo të drejtpërdrejta me kosto financiare vjetore në vlerën 3 912 813 (tre milionë e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e trembëdhjetë) lekë, bazuar në peshën rreth 20% që zënë këto shpenzime ndaj shpenzimeve direkte.

II. Mënyra e llogaritjes së tarifës mujore të një objekti të kategorisë së "I" (parë), në vlerën 228 247 (dyqind e njëzet e tetëmijë e dyqind e dyzet e shtatë) lekë, jepet si më poshtë vijon:

1. Kostoja vjetore për ruajtjen dhe sigurimin e mesatarisht të nëntë objekteve përllogaritet në vlerën vjetore 20 542 266 (njëzet milionë e pesëqind e dyzetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, bazuar në:

- shumën totale të nënpikave A, B dhe C në vlerën 19 564 063 (nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë. Aplikimin e normës së fitimit, në masën 5%, ose vlerë vjetore 978 203 (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tre) lekë.

2. Kosto mujore për ruajtjen dhe sigurimin e 1 (një) objekti përllogaritet në vlerën 190 206 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtë) lekë, bazuar kjo në vlerë vjetore prej 20 542 266 (njëzet milionë e pesëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, pjesëtuar me numrin e muajve dhe numrin e objekteve.

3. Mbi këtë kosto mujore, aplikohet TVSH-ja në masën 20%, ose 38 041 (tridhjetë e tetë mijë e dyzet e një) lekë.

5. Mënyra e llogaritjes së kostos financiare vjetore për ruajtjen dhe sigurimin e objektit të kategorisë "II" (dytë) bazohet në elementët e shërbimit dhe shpenzimeve të çdo elementi, si më poshtë vijon:

- kostoja për ruajtjen e objektit të kategorisë "II" (dytë), llogaritet duke u bazuar në tarifën mujore të objektit të kategorisë "I" (parë), plus numrin e nevojshëm të rojeve për atë objekt.

- Koston mujore, për një roje.

Elementet e kostos mujore për një roje:

Paga dhe sigurimet shoqërore, janë në vlerën mujore 63 277 (gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

Shpenzime për uniformë (veshmbathje) llogaritet në vlerë fillestare 93 500 (nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, me afat përdorimi 3 vjet, ose kosto vjetore 31,116 (tridhjetë e njëmijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, kjo shumë pjesëtuar me 12 muaj, jep koston mujore në vleftën 2 597 (dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

- Shpenzime administrative dhe të tjera janë llogaritur me koeficientin 3% mbi koston direkte mujore ose 1 976 (një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë (63 277 + 2 597).

- Kostoja mujore për një roje llogaritet në shumën 67 850 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë.

Mbi këtë kosto 67 850 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë aplikohet norma e fitimit në masën 5% , ose vlerë vjetore 3 393 lekë (tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

- Çmimi për një roje pa TVSH është 71 243 (shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë.

6. Për objektet që kanë sistem ruajtje me një dhe dy roje, përllogaritja e tarifës do të bëhet duke pasur parasysh sigurinë e objekteve dhe koston aktuale që kanë këto objekte për sigurinë. Përcaktimi i tarifës do të bëhet me marrëveshje midis Shoqërisë "Illyrian Guard" sh.a. dhe subjekteve që kërkojnë shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë pa kaluar nivelin aktual të buxhetit të sigurisë.

7. Ngarkohet Shoqëria "Illyrian Guard" sh.a., për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 400, datë 25.6.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES, PËR KUSHTET E SHËNDETIT TË KAFSHËVE, QË NDIKOJNË NË TREGTINË DHE PËRDORIMIN E EMBRIONEVE TË KAFSHËVE, TË MBARËSHTIMIT TË LLOJIT GJEDH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 40, të ligjit nr. 9426, datë, 6.10.2005,"Për mbarështimin e blegtorisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores për kushtet e shëndetit të kafshëve që ndikojnë në tregtinë dhe përdorimin e embrioneve të kafshëve të mbarështimit të llojit gjedh, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe të mbrojtjes së bimëve, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

RREGULLORE[1]
PËR KUSHTET E SHËNDETIT TË KAFSHËVE QË NDIKOJNË NË TREGTINË DHE PËRDORIMIN E EMBRIONEVE TË KAFSHËVE TË MBARËSHTIMIT TË LLOJIT GJEDH

1. Kjo rregullore përcakton kushtet e shëndetit të kafshëve që ndikojnë në tregtinë brenda vendit, importin dhe përdorimin e embrioneve të freskëta dhe të ngrira të kafshëve të llojit gjedh.

Kjo rregullore nuk zbatohet për embrionet që përftohen nga transferimi i qelizës.

2. Për qëllimin e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Embrion", nënkupton fazën fillestare të zhvillimit të një kafshe mbarështuese të specieve të llojit gjedh, e cila është e aftë të transferohet në një vend tjetër;

b) "Subjekti i mbledhjes së embrioneve", nënkupton një grup të miratuar zyrtarisht teknikësh, ose një grup veterinerësh kompetent që mbikëqyrin mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e embrioneve në bazë të kushteve të përcaktuara në aneksin A të kësaj rregulloreje;

c) "Veterineri i ekipit", nënkupton veterinerin përgjegjës për mbikëqyrjen e një ekipi të mbledhjes së embrionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në aneksin A;

d) "Ngarkesë e embrioneve", nënkupton një sasi të embrioneve të dërguara nga një subjekt i vetëm, të cilat janë të shoqëruara nga një certifikatë e vetme;

e) "Vendmbledhje", nënkupton vendin në të cilat embrionet janë prodhuar, mbledhur, përpunuar, dhe aty ku është e nevojshme, magazinuar, të cilat dërgohen në një vend tjetër;

f) "Laborator diagnostik i autorizuar" nënkupton një laborator, të autorizuar nga ministri, për të kryer testet diagnostikuese të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje;

g) "Ekipi i prodhimit të embrionit" nënkupton një ekip të mbledhjes, të embrionit të miratuar zyrtarisht për fekondim *in vitro* në përputhje me kushtet e përcaktuara në aneksin A.

3. Embrionet nuk qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse nuk plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) embrionet duhet të kenë ardhur si rezultat i inseminimit artificial me spermë ose fertilizimit *in vitro* nga një kafshë donatore e cila qëndron në një qendër prodhimi të spermës, të miratuar. Shërbimi veterinar rajonal, mund të autorizojë tregtinë e embrioneve të specieve të caktuara specifike të ardhura si rezultat i shërbimit natyror nga demat, gjendja shëndetësore e të cilëve është në përputhje me Aneksin B të kësaj rregulloreje;

b) embrionet duhet të jenë mbledhur nga kafshët e mbarështimit të gjedhit, gjendja shëndetësore e të cilëve është në përputhje me Aneksin B të kësaj rregulloreje;

c) embrionet duhen të mblidhen, përpunohen dhe ruhen nga një subjekt i miratuar i mbledhjes së embrioneve;

d) embrionet duhen të mblidhen, përpunohen dhe ruhen nga një ekip i mbledhjes së embrioneve në përputhje me aneksin A të kësaj rregulloreje;

e) embrionet duhet të shoqërohen, gjatë transportit me certifikatën e shëndetit të kafshëve në përputhje me pikën 5 të kësaj rregulloreje;

4. Miratimi i ekipeve për mbledhjen e embrioneve, siç parashikohet në këtë rregullore, bëhet nga Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve (ARSHVMB) dhe jepet vetëm kur subjekti i mbledhjes së embrioneve, është në gjendje të plotësojë dispozitat e kësaj rregulloreje dhe plotëson kërkesat e kreut I, të aneksit A. Për çdo ndryshim të bërë në organizimin e ekipit, duhet të njoftohet ARSHVMB-së.

Miratimi i ekipit, duhet të rinovohet sa herë që në subjekt, ndodhin zëvendësime ose kur do që të bëhen ndryshime të mëdha në organizim, laboratorët ose pajisjet që janë në dispozicion të tij.

Veterineri zyrtar duhet të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të dhëna më sipër. Heqja e miratimit, bëhet kur një ose më shumë dispozita nuk zbatohen më nga ky subjekt.

Të gjitha subjektet e miratuara të mbledhjes së embrioneve regjistrohen nga ARSHVMB-ja, ku secilit subjekt, i jepet një numër regjistrimi. Lista

[1] Kjo rregullore është përafruar pjesërisht me:

Direktivën e Këshillit 89/556/EEC të 15 shtator 1989, i ndryshuar, mbi kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullojnë tregtinë intra-Komunitare dhe importimin nga vendet e treta të embrioneve të kafshëve shtëpiake të llojit të gjedhëve CELEX 1989L0556; FZ L 302, 19.10.1989, f. 1.

e subjekteve veterinare të mbledhjes së embrioneve, së bashku me numrin e tyre të regjistrimit duhet t'i dërgohen autoritetit kompetent, i cili njofton shërbimin veterinar në të gjitha rajonet.

Kur shërbimi veterinar rajonal, vëren se dispozitat e kësaj rregulloreje nuk janë zbatuar nga një subjekt i mbledhjes së embrioneve në një rajon të caktuar, ai duhet të informojë ARSHVMB-në, i cili njofton agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve në të gjithë territorin e vendit. Shërbimi veterinar rajonal merr të gjitha masat e nevojshme lidhur me shkeljet e konstatuara dhe njofton për masat e marra ARSHVMB-në.

Miratimi i një ekipi të prodhimit të embrionit për embrionet që përftohen nga fekondimi *in vitro* jepet vetëm nëse garantohet që ekipi i prodhimit të embrionit plotëson dispozitat e kësaj rregulloreje dhe të aneksit A, në veçanti dispozitat e kësaj pike dhe kësaj rregulloreje të zbatohen plotësisht, pikë për pikë.

5. Certifikata e shëndetit të kafshës, lëshohet nga veterineri zyrtar ose veterineri i autorizuar, në formatin, modeli i të cilit jepet në aneksin C, e cila shoqëron çdo dërgesë embrionale. Për secilën dërgesë lëshohet një certifikatë e veçantë.

Certifikata e shëndetit të kafshës duhet të:

- jetë individuale për çdo ngarkesë;

- shoqërojë dërgesën e embrioneve në destinacionin, në formën e tij origjinale.

6. Embrionet importohen vetëm nga vende ose pjesë të tyre që paraqesin gjendje të mirë shëndetësore të gjedhit, kafshëve të tjera që mbarështohen dhe kafshëve të egra që gjenden në këto vende, veçanërisht ndaj sëmundjeve ekzotike të kafshëve dhe gjendjes shëndetësore mjedisore të atij vendi, të cilat mund të rrezikojnë shëndetin e kafshëve në vendet e destinacionit.

7. Subjektet e mbledhjes se embrioneve që kryejnë eksport për në Republikën e Shqipërisë duhet:

- të jenë miratuar zyrtarisht për eksport; dhe

- janë subjekt i inspektimeve të paktën dy herë në vit nga një veteriner zyrtar i atij vendi.

8. Importimi i embrioneve nga territori i një vendi ose pjesë të tij do të bëhen vetëm nëse embrionet:

- vijnë nga kafshë donatore, të cilat para mbledhjes së embrioneve kanë qenë për të paktën gjashtë muaj në territorin e atij vendi të origjinës.

- kanë plotësuar kërkesat e shëndetit të kafshëve, të miratuara në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, për importin e embrioneve.

Për miratimin e kërkesave të përmendura në shkronjën "b", duhet të mbahet parasysh:

- gjendja shëndetësore në zonën përreth vendit të mbledhjes të embrioneve, duke iu referuar veçanërisht sëmundjeve që paraqiten në listën e përcaktuar të Zyrës Ndërkombëtare të Sëmundjeve Epizootike;

- gjendja shëndetësore e tufës në fjalë për mbledhjen e embrioneve, duke përfshirë kërkesën për testim;

- gjendja e shëndetit të kafshëve donatore dhe kërkesa për testim;

- mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e embrioneve.

Dispozitat referuese për përcaktimin e kushteve të shëndetit të kafshëve në përputhje me paragrafin e mësipërm, për Tuberkulozin, Brucelozën e gjedhëve dhe Leukozën Enzootike janë përcaktuar në anekset A dhe G të rregullores nr. 255, datë 18.5.2008, "Mbi përcaktimin e kërkesave të shëndetit të kafshëve në tregtinë e brendshme të llojit gjedh dhe derra".

9. Në përcaktimin e shëndetit të kafshëve, në lidhje me Aftën Epizootike, të merret parasysh edhe se:

- vetëm embrionet e ngrira mund të importohen nga vendet ku praktikohet vaksinimi kundër sëmundjes Afta Epizootike. Embrionet duhet të ruhen në kushte të miratuara për një minimum prej 30 ditësh para dërgesës,

- kafshët donatore duhet të vijnë nga një fermë në të cilën asnjë kafshë nuk është vaksinuar kundër sëmundjes së Aftës Epizootike gjatë 30 ditëve para mbledhjes dhe që nuk i nënshtrohet ndonjë ndalimi ose mase karantine.

10. Importimi i embrioneve bëhet i shoqëruar me certifikatën e shëndetit të kafshës, hartuar dhe nënshkruar nga veterineri zyrtar.

Certifikata duhet:

- të jetë e hartuar të paktën në gjuhën zyrtare të vendit të origjinës dhe gjuhën shqipe;

- të bëhet për një ngarkesë të vetme;

- të shoqërojë në formë origjinale embrionet që nga origjina e tyre.

11. Pranimi i embrioneve, nuk lejohet nëse gjatë kontrollit të importit rezulton se:

a) embrionet nuk vijnë nga territori i një vendi sipas përcaktimit të pikës 6 të kësaj rregulloreje.

b) embrionet nuk janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur nga subjekti i mbledhjes së embrioneve, sipas përcaktimeve të pikës 8 të kësaj rregulloreje.

c) embrionet vijnë nga vend, ose pjesë të territorit të tyre nga i cili importi i është ndaluar;

d) certifikata e shëndetit të kafshës që shoqëron embrionet nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

12. Nëse një sëmundje infektive e kafshëve mund të mbartet nga embrionet ose të shpërthejë e të përhapet, apo ndonjë arsye tjetër që lidhet me shëndetin e kafshëve, mund të rrezikojë shëndetin e kafshëve të tjera, shërbimi veterinar rajonal në ARSHVMB, duhet:

- të marrë masat në përputhje me rregulloren nr. 255, datë 18.5.2008, mbi përcaktimin e kërkesave të shëndetit të kafshëve në tregtinë e brendshme të llojit gjedh dhe derra;

- të ndalojë lëvizjen e embrioneve në mënyrë direkte ose indirekte nga territori i vendit ku është shfaqur sëmundja.

ANEKSI A
KAPITULLI I
KUSHTET PËR MIRATIMIN E MBLEDHJES TË EMBRIONEVE DHE EKIPEVE TË PRODHIMIT TË EMBRIONIT

Në mënyrë që t'i jepet aprovimi një ekipi të mbledhjes së embrioneve, subjektet duhet të plotësojnë këto kërkesa:

a) mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e embrioneve duhet të kryhet nga një veteriner i subjektit ose nën përgjegjësinë e tij nga një ose më shumë teknikë të cilët janë të aftë dhe të trajnuar nga veterineri i subjektit me metodat dhe teknikat e higjienës;

b) ato duhet të vendosen nën mbikëqyrjen e përgjithshme të autoritetit të veterinerit zyrtar;

c) duhet të kenë në dispozicion pajisje laboratorike të përhershme ose të lëvizshme ku embrionet mund të ekzaminohen, përpunohen dhe paketohen, të ketë të paktën një sipërfaqe pune, një mikroskop dhe pajisje kriogjene;

d) Në rastin e një laboratori të përhershëm, ai duhet të ketë në dispozicion:

- një dhomë ku embrionet mund të manipulohen, e cila është ngjitur, por e ndarë fizikisht nga zona e cila përdoret për të marrë apo manipuluar kafshët donatore gjatë mbledhjes,

- një dhomë ose një zonë, ku kryhet pastrimi dhe sterilizimi i instrumenteve dhe i pajisjeve të përdorura në mbledhjen dhe manipulimin e embrionit;

- kur duhet të kryhet mikromanipulimi i embrionit që përfshin depërtimin e zona pellucida, kjo duhet bërë në pajisje të përshtatshme me pllakëza rrjedhëse që duhet të pastrohen dhe dezinfektohen në mënyrë të përshtatshme midis porcioneve.

e) Në rastin e një laboratori të lëvizshëm, duhet të ketë në dispozicion, një zonë specifike që përbëhet nga dy seksione të ndara:

- specifikisht një për ekzaminimin dhe manipulimin e embrioneve, e cila duhet të jetë një seksion steril,

- një tjetër për vendosjen e mjeteve dhe materialeve të përdorura që kanë qenë në kontakt me kafshët donatore.

Një laborator i lëvizshëm duhet të ketë gjithmonë kontakt me një laborator të përhershëm për të siguruar sterilizimin e pajisjeve të tij dhe sigurimin e materialeve dhe produkteve të tjera të nevojshme për mbledhjen dhe manipulimin e embrioneve.

Për më tepër, për t'u miratuar si ekip për prodhimin dhe përpunimin e embrione të nxjerra nga fekondimi *in vitro* dhe/ose kultura *in vitro*, ekipi i prodhimit duhet të plotësojë kërkesat shtesë në vijim:

f) personeli të jetë i trajnuar në kontrollin e përshtatshëm të sëmundjes dhe teknikat laboratorike, veçanërisht në procedurat për të punuar në kushte sterile;

g) të ketë në dispozicion një laborator përpunimi të përhershëm, i cili duhet:

- të ketë pajisje dhe hapësira të përshtatshme, duke përfshirë një dhomë të veçantë për të nxjerrë vezët nga vezoret dhe dhoma ose zona të ndara për përpunimin e vezëve dhe embrioneve dhe ruajtjes së embrioneve,

- të ketë pajisje me pllakëza rrjedhëse nën të cilat të gjitha vezët, spermatozoidet dhe

embrionet duhet të përpunohen; megjithatë centrifugimi i spermës mund të kryhet jashtë pajisjes me pllakëza rrjedhëse, për aq kohë sa janë marrë masa të plota higjienike;

h) kur vezët dhe indet e tjera duhet të mblidhen në një thertore, ajo duhet të ketë në dispozicion pajisje të përshtatshme për mbledhjen dhe transportimin e vezoreve dhe indet e tjera në laboratorin e përpunimit në një mënyrë higjienike dhe të sigurt.

KAPITULLI II
KUSHTET QË LIDHEN ME MBLEDHJEN, PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE TRANSPORTIN E EMBRIONEVE NGA SUBJEKTET E MIRATUARA TË MBLEDHJES SË EMBRIONEVE

1. Mbledhja dhe përpunimi

a) Embrionet mblidhen dhe përpunohen nga një subjekt i miratuar i mbledhjes, pa qenë në kontakt me ndonjë ngarkesë tjetër të embrioneve që nuk plotësojnë kërkesat e kësaj rregulloreje.

b) Embrionet duhet të mblidhen në një vend i cili është i izoluar nga pjesë të tjera të stabilimenteve të cilat duhet të jenë në gjendje të mirë dhe për t'u pastruar e dezinfektuar me lehtësi.

c) Embrionet duhet të përpunohen (ekzaminohen, lahen, trajtohen dhe vendosen në kontejnerë të identifikuar dhe sterilë) në një laborator të përhershëm ose në një objekt laboratori të lëvizshëm, i cili nuk gjendet në një zonë që i nënshtrohet masave ndaluese ose karantinës.

d) Të gjitha mjetet që janë në kontakt me embrionet ose kafshët donatore gjatë mbledhjes dhe përpunimit duhet të dezinfektohen ose sterilizohen siç duhet, përpara përdorimit të tyre.

e) Produktet me origjinë shtazore të përdorura gjatë mbledhjes të embrioneve dhe mjetet e transportit, duhet të merren nga burime të cilat nuk paraqesin rrezik për shëndetin e kafshëve ose që të trajtohen në mënyrë të tillë para përdorimit, që të mos përbëjnë rrezik.

f) Mjetet e ruajtjes dhe mjetet transportuese duhet të dezinfektohen ose sterilizohen siç duhet përpara fillimit të çdo procedure që do të kryhet me to.

g) Agjenti kriogjenik i përdorur nuk duhet të përdoret më për produktet e tjera me origjinë shtazore.

h) Çdo kontejner embrioni dhe kontejnerët në të cilat ato ruhen dhe transportohen duhet të jenë të koduar apo markuar në mënyrë të tillë që data e mbledhjes të embrioneve, raca, identifikimi i kafshëve donatore, si dhe numri i regjistrimit të subjektit mund të lexohen lehtësisht.

i) Çdo embrion duhet të lahet së paku 10 herë në një lëng të veçantë për embrionet, i cili duhet të ndryshohet çdo herë. Lëngu duhet të përmbajë trypsinë, në përputhje me procedurat e njohura ndërkombëtarisht. Secila larje duhet të ketë një hollim 100 herë më shumë nga larja e mëparshme dhe duhet të përdoret një mikropipetë sterile e cila përdoret për të transferuar embrionin në çdo rast.

j) Pas larjes së fundit, secili embrion i nënshtrohet ekzaminimit mikroskopik me zmadhim të paktën 50 herë në të gjithë sipërfaqen e tij për të përcaktuar nëse "zona pellucida" është e paprekur ose e lirë nga çdo material ngjitës. Çdo mikromanipulim që sjell penetrimin në zonën pellucida duhet të kryhet duke përdorur dispozitiv të posaçëm dhe pas larjes së fundit dhe kontrollit. Një mikromanipulim i tillë nuk mund të kryhet në një embrion zona pellucida e të cilit nuk rezulton e paprekur.

k) Secila ngarkesë e embrioneve që ka kaluar me sukses ekzaminimin e parashikuar në shkronjën "j" të kësaj pike, vendoset në një enë sterile, në përputhje me shkronjën "h" të kësaj pike, e cila vuloset apo shënjohet menjëherë.

l) Çdo embrion, aty ku është e përshtatshme, duhet të kalojë procesin e ngrirjes sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të ruhet në një vend që është nën kontrollin e veterinerit zyrtar, si dhe t'i nënshtrohet njëherazi edhe inspektimit të rregullt nga ana e veterinerit zyrtar.

m) Çdo subjekt i mbledhjes duhet të paraqesë mostra rutinë të lëngjeve që përdoren për larje, lëngje larëse, embrione të shkatërruara, vezë jo të fekonduara etj., që merren nga aktiviteti i tyre, për ekzaminim zyrtar për ndotje bakteriale dhe virale.

n) Çdo subjekt i mbledhjes së embrioneve duhet të mbajë një regjistër të aktiviteteve të tij

në lidhje me mbledhjen e embrionieve gjatë 12 muajve para dhe 12 muajve pas ruajtjes, duke përfshirë:

- racën, moshën dhe identifikimin e kafshëve donatore në fjalë;
- vendin e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së embrioneve të mbledhura nga ekipi;
- identifikimin e embrioneve së bashku me detajet e destinacionit të tyre, nëse njihen.
- detajet e teknikave të mikromanipulimit, të cilat përfshijnë depërtimin e zonës pellucida, ose teknika të tjera të tilla si fertilizimi *in vitro* dhe/ose kultura *in vitro* të cilat janë kryer në embrione. Në rastin e embrioneve të nxjerra nga fekondimi *in vitro*, identifikimi mund të bëhet në bazë të një sasie, por duhet të përmbajë të dhëna të datës dhe vendit të mbledhjes të vezëve dhe vezoreve. Duhet të jetë gjithashtu i mundur identifikimi i origjinës së kafshës donatore.

Kushtet e përcaktuara në shkronjat "a" deri "n" zbatohen sipas rastit për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe transportimin e vezoreve, vezëve dhe indeve të tjera për përdorim në fekondim in vitro dhe/ose kulturën in vitro. Për më tepër, do të zbatohen kushtet e mëposhtme shtesë:

o) kur vezoret dhe indet e tjera duhet të mblidhen në një thertore, thertorja duhet të aprovohet zyrtarisht dhe nën kontrollin e një veterineri zyrtar, përgjegjësia e të cilit është të kryejë inspektimin ante- dhe post-mortem të donatorëve;

p) materialet dhe pajisjet që vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me vezoret dhe indet e tjera do të sterilizohen para përdorimit dhe pas sterilizimit, të përdoren ekskluzivisht për ato qëllime. Pajisje të posaçme të përdoren për të trajtuar vezët dhe embrionet nga tufa të ndryshme të kafshëve donatore;

q) vezoret dhe indet e tjera nuk duhet të lejohen të hyjnë në përpunim laboratorik deri në përfundimin e inspektimit post-mortem të serisë. Nëse sëmundje relevante gjenden në grupin e donatorëve, ose në ndonjë kafshë të therur në atë thertore në atë ditë, të gjitha indet nga ajo sasi duhet të gjurmohen dhe të hidhen poshtë;

r) procedura e larjes dhe ekzaminimit të përcaktuara në shkronjat "i" dhe "j" do të kryhet pas përfundimit të procedurës së kulturës;

s) çdo mikromanipulim që përfshin depërtimin e zona pellucida do të kryhet në përputhje me dispozitat e germës "j", pasi procedurat e parashtruara në shkronjën "q" kanë përfunduar;

t) vetëm embrionet nga i njëjti grup donatorësh duhet të ruhen në të njëjtën ampulë/tubë.

2. Ruajtja

Çdo subjekt mbledhës i embrioneve duhet të sigurojë që embrionet janë të ruajtura në temperaturë të përshtatshme, të miratuara për qëllimin e tyre, nga shërbimi rajonal veterinar.

Në mënyrë që të miratohen këto subjekte, duhet që:

a) të kenë të paktën një dhomë të mbyllur ekskluzivisht vetëm për ruajtjen e embrionit;

b) mjedisi të jetë lehtësisht i pastrueshëm dhe i dezinfektueshëm;

c) të kenë të dhëna të përhershme për të gjitha lëvizjet hyrëse dhe dalëse të embrioneve. Destinacioni përfundimtar i embrioneve duhet të specifikohet në regjistrime të tilla;

d) i nënshtrohet inspektimit nga veterineri zyrtar.

3. Transporti

Embrionet për tregti duhet të transportohen në kushte të kënaqshme higjienike në kontejnerë të mbyllur nga hapësira e miratuar për ruajtjen deri në arritjen e tyre në destinacion.

Kontejnerët duhet të jenë të emëruar në atë lloj mënyre që numri të përputhet me numrin që është në certifikatën e shëndetit të kafshëve.

ANEKSI B

1. Për qëllime të mbledhjes së embrioneve, kafshët donatore duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) duhet të kenë kaluar të paktën gjashtë muajt e mëparshëm në zonën e mbledhjes;

b) duhet të jenë prezent në tufën e origjinës të paktën 30 ditë përpara mbledhjes;

c) duhet të vijnë nga tufa të cilat:

- të jenë zyrtarisht të pastra nga tuberkulozi;
- të jenë zyrtarisht të pastra nga bruceloza;
- të jenë të lira nga leukoza enzotike e gjedhit.

Përjashtim bëjnë kafshët që mund të vijnë nga një tufë (ose tufa) që nuk janë pa leukozë, por për të cilat është marrë certifikata se nuk ka pasur

ndonjë rast klinik të leukozës së gjedheve enzootike gjatë tre viteve të fundit.

- përgjatë vitit të mëparshëm kanë qenë në një tufë (tufa) që nuk ka shfaqur shenja klinike të rinotrakeitit infektiv të gjedhit dhe vulvo-vaginiti infektiv pustular.

2. Në ditën e mbledhjes së embrionit dhuruesi:

a) duhet të jetë rezident në një njësi i cili nuk është subjekt i ndalimit veterinar ose masave të karantinës;

b) nuk duhet të shfaqë shenja klinike të sëmundjes.

3. Për më tepër, kushtet e mësipërme do të zbatohen për kafshët e gjalla të destinuara si dhurues të vezëve me anë të "ovum pickup" ose ovariektomisë.

4. Në rastin e donatorëve të vezoreve dhe indeve të tjera që do të mblidhen pas therjes në një thertore, ata nuk duhet të jenë caktuar për therje si pjesë e një programi për çrrënjosjen e sëmundjeve kombëtare dhe as nuk duhet të kenë ardhur nga një fermë e cila është subjekt i kufizimeve për shkak të sëmundjes së kafshëve.

5. Thertoret ku mblidhen vezoret dhe indet e tjera nuk duhet të vendosen në një zonë që i nënshtrohet masave ndaluese ose karantinore.

ANEKSI C
CERTIFIKATË SHËNDETËSORE VETERINARE PËR TREGTINË E EMBRIONEVE TË KAFSHËVE TË LLOJIT GJEDH

VETERINARY HEALTH CERTIFICATE FOR TRADE OF BOVINE EMBRYOS
CERTIFIKATË SHËNDETËSORE VETERINARE PËR TREGTINË E EMBRIONEVE TË KAFSHËVE TË LLOJIT GJEDH

Part I: Details of consignment presented/ Pjesa I:Detajet e dërgesës së paraqitur

I.1. Consignor Dërguesi
Name
Emri
Address
Adresa
Postal code
Kodi postar

I.2. Certificate reference num
Numri i referencës së Certifikatës

I.2.a.

I.3. Central competent Authority Autoriteti Kompetent Qendror

I.4.
Local Competent Authority
Autoriteti Kompetent Lokal

I.5. Consignee Marrësi
Name
Emri
Address
Adresa
Postal code
Kodi postar

I.6. No(s) related original certificates
Nr. i lidhur me certifikatën e origjinës

I.7.

I.8.Country of origin Shteti i origjinës **ISO code** ISO Kodi

I.9. Region of origin, Code Rajoni i origjinës, Kodi

I.10. Country of destination Shteti i destinacionit **ISO code** ISO kodi

I.11. Region of destination Rajoni i destinacionit **Code** Kodi

I.12. Place of origin Vendi i origjinës **Embrio team** ☐ Subjekti i mbledhjes së embrioneve
Approved body ☐ Autoriteti Kompetent
Name
Emri **Approval number** Numri i Aprovimit
Address
Adresa
Postal code
Kodi postar

I.13. Place of destination Vendi i destinacionit
Approved body ☐ Autoriteti Kompetent **Embrio team** ☐ Subjekti mbledhjes së embrioneve
Holding ☐ Stabiliment **Other** ☐ Të tjera
Name
Emri **Approval number** Numri i Aprovimit
Address
Adresa
Postal code
Kodi postar

I.14

I.15.

I.16. Means of transport Mjeti i transportit
Aeroplane ☐ Aeroplan **Ship** ☐ Anije **Railway wagon** ☐ Hekurudhë
Road vehicle ☐ Automjet **Other** ☐ Tjetër

I.17.

I.18. Animal species/products
Specia e kafshës/produkteve

I.19. Commodity code (CN code)
Kodi i mallit/artikullit (kodi CN)

I.20. Number/Quantity Numri/Sasia

I.21.

I.22. Number of packages Numri i pakove

I.23. Identification of container/Seal number Identifikimi i kontenierit/numri i vulës	I.24.

I.25. Animal certified as/ products certified for:
Kafshë të certifikuar si/ Produkte të certifikuar për:

Artificial reproduction ☐
Riprodhim Artificial

I.26. Tranzsit through Third country Transit në shtetet e treta ☐ **Third country** **ISO code** Shteti i tretë kodi ISO **Exit point** **Code** Pika e daljes K**odi** **Entry point** **BIP unit no.:** Pika e hyrjes PKK nr:	I.27. Tranzsit through Member States Transit në shtetet Anëtare ☐ **Member State** **ISO code** Shteti anëtar kodi ISO **Member State** **ISO code** Shteti anëtar kodi ISO **Member State** **ISO code** Shteti anëtar kodi ISO
I.28. Export Eksport ☐ **Third country** **ISO code** shteti i tretë kodi ISO **Exit point** **Code** Pika e daljes K**odi**	I.29.

I.30.

I.31. Identification of the animals/products
Identifikimi i kafshëve/produkteve

Species (Scientific name) Speciet (Emri shkencor)	Identification mark Numri identifikimit	Category Kategoria	Approval number of the team Numri aprovues i subjektit mbledhës të embrioneve

Part II: Certification / Pjesa II: Certifikata

II.a. Certificate reference number Certifikatë me numër reference	II.b.

II. **HEALTH INFORMATION** / INFORMACION SHËNDETËSOR

I, the undersigned official veterinarian, hereby certify that the embryos described in this certificate:
Unë, i nënshkruari veteriner zyrtar, me anë të kësaj certifikate vërtetoj, që embrionet e përshkuara në këtë certifikatë:

II.1 Were collected, processed and stored in compliance with Annex A to Directive 89/556/EEC;
Janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me Shtojcën A të Direktivës 89/556/EEC;

II.2 Were sent to the place of loading in sealed containers in compliance with Annex A to Directive 89/556/EEC;
Janë dërguar në vendin e dërgimit në kontenierë të mbyllur, në përputhje me Shtojcën A të Direktivës 89/556/EEC;

II.3 Come from donors of the bovine species wich comply with Annex B to Directive 89/556/EEC;
Vijnë nga specie gjedhi donatore, në përputhje me Shtojcën B të Direktivës 89/556/EEC;

II.4 Were conceived either by artificial insemination or by *in vitro* fertilization ([1]) using semen coming from semen coming from semen collection or storage centeres approved in accordance with Directive 88/407/EEC and located in a Member State of European Community or in a third country listed in Annex I to Commission Decision 2004/639/EC ([1]) ([2]).
Vijnë edhe nga inseminimi artificial ose nga fertilizimi *in vitro* ([1]) duke përdorur spermën e cila vjen nga qendrat e mbledhjes dhe ruajtjes së sperms të aprovuara në përputhje me Direktivën 88/407/EEC dhe të lokalizuara në një vend anëtar të Komunitetit Evropian ose të një vendi të tretë të listuar në Shtojcën I të Vendimit të Komisionit 2004/639/EC ([1]) ([2]).

Official veterinarian
Veterineri Zyrtar

Name (in capital letters):
Emri (me shkronja të mëdha):

Local Veterinary Unit:
Njësia Veterinare Lokale:

Date/
Data:

Official stamp/
Vula zyrtare:

Vula

Qualification and title:
Kualifikimi dhe titulli:

No of the LVU:
Nr. i Njësisë Veterinare Lokale:

Signature:
Nënshkrimi:

KËRKESË

Shtetasi Agron Toqi kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të vdekur të shtetasit Ramiz Mustafa Toqi, në datën 31.12.1962.

KËRKUES
Agron Toqi

KËRKESË

Shtetasja Evis Shkëmbi (Sharko) kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Viktor Thodhor Sharko, i datëlindjes 3.1.1932.

KËRKUESE
Evis Shkëmbi (Sharko)

KËRKESË

Shtetasja Albana Malja kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Dhimitër Malja, i datëlindjes 15.9.1962.

KËRKUESE
Albana Malja

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë